

20250871939

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenin 27 të Ligjit për Inspektim Arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

R R E G U L L O R E **PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN PËR KRYERJEN E MBIKËQYRJES** **INSPEKTUESE**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe procedura për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, e cila kryhet nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe inspektorit të autorizuar të komunës, përkatësisht i qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: inspektorët e arsimit).

Neni 2

Vlerësimi integral kryhet nga ekipi i inspektorëve shtetërorë të arsimit (në tekstin e mëtejme: ekipi).

Përbërja e ekipit dhe ditët e inspektimit përcaktohen varësisht madhësisë dhe kompleksitetit të institucioneve edukativo-arsimore

Neni 3

Përbërja e ekipit dhe udhëheqësi i të njëjtit, emri i institucionit edukativo - arsimor ku do të kryhet vlerësimi integral dhe data, përcaktohen nga drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, ndërsa tregohet kujdes që anëtarët e ekipit të mos jenë në konflikt interesi me institucionin edukativo - arsimor ku kryhet mbikqyrja inspektuese.

Neni 4

Vlerësimi integral i institucionit edukativo - arsimor përfshinë: organizimin dhe realizimin e mësimdhënies, kushtet dhe kulturën në institucionet arsimore, menaxhimin, përmbushjen dhe vlerësimin e detyrave të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe drejtues, komunikimin dhe marrëdhëniet me opinionin, bashkëpunimin me prindërit dhe mjedisin etj.

Fushat e mbikëqyrjes inspektuese përmes vlerësimit integral janë fusha që i referohen funksionimit të institucioneve edukativo-arsimore, në cilat fusha plotësohen nevojat dhe pritjet e nxënësve, prindërve dhe punonjësve të institucionit edukativo-arsimor dhe janë si vijon:

a) Për shkollat fillore, treguesit janë të organizuar në katër fusha (që korrespondojnë me kornizën e vetëvlerësimit dhe vlerësimin integral), të cilat i referohen aspekteve kryesore të punës së shkollës:

1. planifikim, mësimdhënie dhe të nxënit,
2. arritjet e nxënësve,
3. klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë dhe
4. menaxhimi, udhëheqja dhe krijimi i politikave.

b) Për shkollë fillore publike me qendër burimore, treguesit janë të organizuar në katër fusha (që korrespondojnë me kornizën e vetëvlerësimit dhe vlerësimin integral), të cilat i referohen aspekteve kryesore të punës së shkollës:

1. planifikim, mësimdhënie dhe të nxënësve,
2. arritjet e nxënësve,
3. klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë dhe
4. menaxhimi, udhëheqja dhe krijimi i politikave.

c) Për shkollë të mesme, treguesit janë të organizuar në shtatë fusha kyçe (që korrespondojnë me kornizën e vetëvlerësimit dhe vlerësimin integral), të cilat i referohen aspekteve kryesore të punës së shkollës:

1. planet dhe programet mësimore,
2. arritjet e nxënësve,
3. të nxënësve dhe mësimdhënienë,
4. mbështetje/ndihmë për nxënësin
5. klima e shkollës,
6. burimet dhe
7. menaxhimi, udhëheqja dhe krijimi i politikave.

Neni 5

Gjatë përcaktimit të institucioneve edukativo-arsimore për vlerësim integral, merren parasysh data dhe konstatimet e vlerësimit integral të mëparshëm.

Neni 6

Përpara se të kryhet vizita në institucionin edukativo- arsimor, udhëheqësi i ekipit informon ekipin, njofton institucionin edukativo-arsimor me shkrim se është planifikuar të zbatohet vlerësim integral dhe dorëzon kërkesë për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm në ekip në formë elektronike ose në formë të letrës edhe atë: pyetësor me të dhëna të përgjithshme për shkollën; tabela për përshtatshmërinë e kuadrit mësimor; tabela e aktiviteteve jashtëshkollore; tabelë e burimeve të bibliotekës; formular për cilësinë e orës mësimore të ndjekur nga shkolla; informacione të shkurtëra për drejtorin e shkollës; listën e dokumenteve nga shkolla; rendin e ditës për takim midis udhëheqësit të ekipit dhe drejtorit; pyetësor për drejtorin; pyetësor për kuadrin e mësimdhënësve ; pyetësor për kuadrin jo-mësimdhënës; pyetësor për prindërit; pyetësor për nxënësit; metodologjia për shpërndarjen e pyetësorëve të shkollave fillore/të mesme; njoftim për prindërit; njoftim për nxënësit; rendi i ditës për takim me këshillin e shkollës; rendin e ditës për takim të ekipit me drejtorin; rendi i ditës për takim me këshillin e prindërve; rendi i ditës për takim me grup mësimdhënës; rendi i ditës për grup me bashkëpunëtor profesional; rendi i ditës për takim me komunitetin lokal dhe afarist dhe rendi i ditës për takim me koordinatorët e ekipeve shkollore të formuara për: vetëvlerësim, përfshirje qytetare, integrim ndëretnik, etj. (në tekstin e mëtejshëm: dokumentacioni i nevojshëm).

Neni 7

Pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm, udhëheqësi i ekipit i shpërndan detyrat.

Neni 8

Para fazës së implementimit udhëheqësi i ekipit realizojnë takim me drejtorin e institucionit edukativo-arsimor.

Neni 9

Me vlerësimin integral sigurohet:

- grumbullimin e të dhënave të mjaftueshme në mënyrë që konstatimet mbi punën e institucionit edukativo -arsimor të jenë të sigurta dhe të besueshme ;
- shqyrtim i plotë i konstatimeve dhe fokusimi në çështjet që janë me rëndësi për institucionin arsimor;
- regjistrimi i të gjitha të dhënave në formularët e regjistrimit dhe
- harmonizimi i konstatimeve të përbashkëta.

Neni 10

Nga anëtarët e bordit të shkollës, anëtarët e këshillit të prindërve, mësimdhënësit dhe nxënësit, plotësohen pyetësorë të standartizuar ose lloje të tjera të materialeve të anketimit të përgatitura nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Nëse institucioni edukativo-arsimor paraprakisht ka kryer shqyrtim të mendimit të prindërve dhe nxënësve dhe dëshiron t'i jep të dhëna për këto mendime, ekipi i shfrytëzon edhe ato rezultate.

Neni 11

Aktivitetet e ekipit zhvillohen sipas planit të mbikëqyrjes inspektuese.
Ekipi grumbullon të dhëna të mjaftueshme për vlerësim.

Neni 12

Gjatë vlerësimit integral, veçanërisht grumbullohen të dhënat nga:

- mbikëqyrjet në mësimdhënie dhe të nxënësve;
- biseda me kuadrin mësimdhënës, nxënësit dhe punonjës të tjerë në institucionin edukativo-arsimor;
- mbikëqyrjet në aktivitetet jashtëshkollore dhe mënyrën në të cilin institucioni edukativo - arsimor kryen aktivitetet e përditshme;
- monitorimi i proceseve në institucionin edukativo - arsimor, siç janë vlerësimi dhe udhëheqja me punët;
- analizimi i shembujve përfaqësues të punës aktuale dhe të kohëve të fundit të nxënësve;
- pjesëmarrja në mbledhje, si për shembull të bordit të shkollës ose seancave të udhëheqsisë dhe vëzhgimi i proceseve të udhëheqjes dhe monitorimit të drejtpërdrejtë të mësimdhënies;
- analizimi i dokumenteve të siguruara nga institucioni edukativo - arsimor, duke përfshirë edhe evidentimin të cilin mësimdhënësit e kanë për nxënësit dhe për progresin e tyre, dhe
- analizimi i evidentimit i cili i referohet nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, duke përfshirë planet mësimore individuale, rishikimet vjetore dhe rishikimet për periudhën kalimtare.

Neni 13

Së paku 20% e kohës së planifikuar për kryerjen e mbikëqyrjes në institucionin edukativo - arsimor, ekipi e shfrytëzon për vizit dhe ndjekje të mësimdhënies, që të mund më pas ekipi të vlerësojë cilësinë e mësimdhënies.

Neni 14

Formularët, së bashku me informatat e shurtëra, planet ose udhëzimet e përgatitura nga udhëheqësi i ekipit, përbëjnë bazën e të dhënave për vlerësimin integral.

Neni 15

Ekipi takohet gjatë vlerësimit integral për t'i ndarë dhe shqyrtuar konstatimet e tij.

Neni 16

Udhëheqësi i ekipit drejton me takimet e ekipit dhe siguron konstatimet për institucionin edukativo - arsimor të harmonizohen bashkërisht, për të identifikuar anët e forta dhe të dobëta të institucionit edukativo - arsimor dhe çfarë duhet bërë për përmirësimin e tyre.

Neni 17

Ekipi shqyrton hapsirat e institucionit edukativo - arsimor, evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin, njihet me rrjedhën e veprimtarisë edukativo - arsimore, bisedon me punonjësit, kryen mbikëqyrje të evidentimit dhe dokumentacionit të institucionit edukativo - arsimor, përcaktojë gjendjen faktike të rëndësishme për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, kryen mbikëqyrje në dokumentacionin për mjetet e fituara nga burimet e veta në institucionet e arsimit të mesëm të themeluara nga vendi, i shqyrton raportet nga projektet ose aktivitetet e veçanta dhe kryen veprime të tjera të cilat janë në përputhje me qëllimin e mbikëqyrjes inspektuese.

Neni 18

Gjatë vizitës në hapsirat e shkollës, ekipi shqyrton të gjithë hapësirën shkollore të institucionit edukativo - arsimor, klasat, fushat e lojërave, terenet sportive, kabinetet, klasat për lëndët mësimore individuale, bibliotekat, punëtoritë në shkollat profesionale, hapsirat sanitare për mësimdhënësit dhe nxënësit etj.

Gjatë vizitës në hapsirat, shqyrtohet veçanërisht:

- respektimi i dispozitave nga fusha e shëndetit dhe sigurisë;
- nëse pajisjet ose mungesa e pajisjeve kanë një ndikim real tek nxënësit në të nxënurit dhe ndaj mirëqenies së tyre; dhe
- nëse hapësira kontribuon në sigurimin e mjedisi të këndshëm për nxënësit.

Neni 19

Gjatë vlerësimit integral, ekipi mbanë takime me:

- anëtarët e këshillit të prindërve,
- përfaqësuesit e mësimdhënësve,
- personelin drejtues në institucionin edukativo - arsimor,
- përfaqësuesit e nxënësve dhe
- anëtarët e këshillit të shkollës.

Takimet nga paragrafin 1 i këtij neni, i drejton udhëheqësi i ekipit.

Neni 20

Gjatë kryerjes së vlerësimit integral, nuk ndryshohen aktivitetet ditore të institucionit edukativo - arsimor.

Neni 21

Pasi që ekipi do të konstatojë konstatimet e tyre, të njejtit i shpjegojë në takime të veçanta me kuadrin drejtues dhe organin menaxhues të shkollës.

Neni 22

Pas marrjes së draft-raportit nga ekipi, nga institucioni edukativo - arsimor informohet komuniteti shkollos (mësimdhënësit, nxënësit, Këshillin e Prindërve dhe këshilli i shkollës) për rezultatet e vlerësimit integral dhe sigurohet disponueshmërinë e raportit të plotë.

Nga institucioni edukativo - arsimor mund të jepen vërejtje në formë me shkrim mbi draft-raportin, të cilat i dorëzohen udhëheqësit të ekipit.

Vërejtjet nga paragrafi 2 i këtij neni, shqyrtohen nga ekipi dhe bëhen pjesë e raportit përfundimtar, nëse ekipi i pranon.

Nga udhëheqësi i ekipit, përgatet një raport përfundimtar, i cili i dorëzohet institucionit edukativo - arsimor.

Neni 23

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, ndalon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese të inspektimit arsimor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 86/06).

Neni 24

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-6208/1
24.4.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr.Dr. **Весна Јаневска**, d.v.